



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDESKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 12, paragrafit 2 dhe 3 dhe nenit 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e 210-të, të mbajtur me datë 10 janar 2019, merr këtë:

### V E N D I M

- I. Gjyqtari i Gjykatës Supreme z. Muhamet Rexha, PEZULLOHET nga detyra e gjyqtarit, gjatë shërbimit në Këshill si kryetari i Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve, i cili pezullim do të përfundojë me datë 5 tetor 2019, me mundësi vazhdimi;
- II. Z. Rexha, gjatë kësaj kohe do të gëzojë pagën ekuivalente të gjyqtarit të Gjykatës Supreme;
- III. Z. Rexha, nuk do të humbas statusin e tij si gjyqtar dhe ka të drejtë t'i kthehet shërbimit si gjyqtarë në gjykatën në të cilën ka shërbyer para emërimit në pozitën sipas pikës I të dispozitivit të këtij vendimi;
- IV. Vendimi hyn në fuqi nga data 11 janar 2019.

### A r s y e t i m

Ligji Nr. 06/L- 055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës është shpallur me dekretin Nr. DL-058-2018, me datë 13.12.2018 nga Presidenti i Republikës së Kosovës. Në bazë të nenit 44 ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Publikimi i ligjit në fjalë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës është bërë me datë 26 dhjetor 2018.

Z. Rexha është zgjedhur anëtar i KGJK-së me datë 4 mars 2016, ndërsa Kryetar i Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve me datë 6 tetor 2016, me mandat tre vjeçar, me mundësi vazhdimi.

Neni 12 paragrafi 2 Ligji Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës obligon kryetarin e Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve që të shërbejë në Këshill me orar të plotë dhe të pezullojë detyrën e gjyqtarit.

Duke marrë parasysh gjithçka që u tha më lartë KGJK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

 Nihat IDRIZI,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

*Kopja e vendimit i dërgohet:*

- Z. Muhamet Rexha, Gjyqtar, Gjykata Supreme e Kosovës;
- Z. Enver Peci, Kryetar, Gjykata Supreme e Kosovës;
- Drejtorit të Sekretariatit të KGJK-së;
- Arkivës.